



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0309

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “EJONA Sh.P.K” kundër Vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të – KOMUNA E PEJËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit në Palestrën e sporteve Karagaq në Pejë LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit në Palestrën Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit në Palestrën e sporteve Karagaq” me nr. të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1", me 15/07/2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “EJONA Sh.P.K” me nr. 2024/309, e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit në Palestrën e sporteve Karagaq në Pejë LOT 1 Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit në Palestrën Karagaq” me nr. të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJËS.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues -KOMUNA E PEJËS, i datës 21.03.2024, për anulimin e aktivitetit të prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 09.06.2023 KOMUNA E PEJËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi

i ndriqimit në Palestrën e sporteve Karagaq në Pejë LOT 1 Instalimi i ngrohjes qëndrore dhe ventilimit në Palestrën Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit në Palestrën e sporteve Karagaq” me nr. të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1". Ndërsa me datë 26.07.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku shpërblen me kontratë për LOT 1 OE “CTA Sh.P.K.” aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 590,870.72 euro.

Me 26.03.2024 OE “EJONA Sh.P.K” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.03.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “EJONA Sh.P.K” me nr. 309/2024 lidhur me aktivitetin “Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit në Palestrën e sporteve Karagaq në Pejë LOT 1 Instalimi i ngrohjes qëndrore dhe ventilimit në Palestrën Karagaq dhe Leshan LOT 2 Rregullimi i ndriqimit në Palestrën e sporteve Karagaq” me nr. të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “EJONA Sh.P.K” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet e OE ankues : Kjo ankesë drejtohet në lidhje me rivlerësimin e ofertës së kompanisë "EJONA" SH.P.K. për aktivitetin e caktuar. Komisioni i ri-vlerësimit ka shkelur Nenin 39 të ligjit të prokurimit publik, pasi ka vepruar jashtë fushës së tyre të ekspertizës, duke sjellë një raport jo-profesional dhe tendencioz. Në vlerësimin e specifikimeve teknike të ofertës sonë, komisioni ka konstatuar se ofertat nuk përputhen me kërkesat e specifikimit teknik të përcaktuara në dokumentin e tenderit. Për shembull, kapaciteti ngrohës dhe dimensionet fizike të prezantuara në ofertën tonë nuk përputhen me kërkesat e specifikimit teknik. Kundërshtimi ynë bazohet në rregullat e Udhëzuesit Nr.001/2023 për prokurimin publik, që ndalon përdorimin e referencës ndaj markave të caktuara, emrave të brendit, ose prodhuesve të veçantë në specifikimet teknike. Megjithatë, komisioni ka kërkuar që produktet të jenë 100% të njëjta me ato që janë referuar në dokumentacionin e tenderit, duke shkelur kështu Nenin 28 të ligjit. Për të mbështetur pretendimet tona, kemi paraqitur një katalog të prodhuesit të ekvivalentit MIDEA, ku fuqia e chillerit është e përshtatshme për kërkesat e specifikimeve teknike. Gjithashtu, kemi prezantuar një diagramë të punës së chillerit për të treguar se produkti përputhet me kërkesat e specifikimeve teknike, pavarësisht ndryshimeve të vogla në dimensione. Përkatesisht kërkesës për rekuperatorin, kemi paraqitur një rekuperator të prodhuesit FAN MAK, i cili përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në specifikimet teknike. Komisioni ka deklaruar se rekuperatori është i prodhuesit MIDEA, duke bërë një gabim në identifikimin e prodhuesit. Pretendimi ynë kryesor është se komisioni i ri-vlerësimit është joprofesional dhe tendencioz, dhe është caktuar pa njohuri

të mjaftueshme në fushën makinerike. Kjo sjellje është e papranueshme dhe po bën që procesi i prokurimit të mos jetë i drejtë dhe i barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Për të mbrojtur të drejtat tona, kërkojmë nga organi i prokurimit publik që të ndalojë veprimet tendencioze të AK-së dhe të detyrojë rishqyrtimin e lëndës në përputhje me ligjin. Po ashtu, kërkojmë që AK të japë një vërejtje të duhur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "EJONA Sh.P.K" konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me LPP të RK 04/1-042 Neni 39 nënparagrafi 39.5 dhe 39.9. UDHËZUESIN Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK Nenet: 28, 43 dhe 59 .Ne i kërkojmë nga OSHP që të ndalojë këto veprime tendencioze të AK, i cili tash e 10 muaj vazhdon me çdo kusht të gjejë çfarë do lloj argumenti vetëm që të mos na shpallë fitues se këtij aktiviteti. Pra, kërkojmë nga OSHP që të detyrojë përsëri AK që të kthejë lëndën në rivlerësim si dhe ta shqiptojë vërejtjen e duhur sipas LPP.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Pas analizës së kërkesës për Rishqyrtim të paraqitur nga Operatori Ekonomik "EJONA SH.P.K", Autoriteti Kontraktues, në datën 27.03.2024, ka vlerësuar kërkesën dhe ka nxjerrë vendimin si më poshtë:

Pas kujdesit të veçantë dhe analizës së kërkesës së paraqitur në platformën elektronike në datën 26.03.2024, komisioni ri-vlerësues, i cili përbëhej nga tre anëtarë profesionistë me tituj inxhinierie në fushën e caktuar, ka konstatuar se sqarimet e paraqitura nga Operatori Ekonomik "EJONA SH.P.K" lidhur me katalogjet e tyre nuk përputhen me specifikat e kerkuara në Fletën e Deklaratës Teknike (FDT). Specifikimet teknike në FDT për pozicionin C.1 kërkonin një pompe termike ajër/ujë (chiler) me karakteristika të caktuara, përfshirë kapacitetin e ngrohjes dhe dimensionet e caktuara. Megjithëse Operatori Ekonomik "EJONA SH.P.K" ka prezantuar katalogun e markës MIDEA duke pretenduar përputhje me specifikat teknike, komisioni ka vërejtur se katalogu nuk përmbush këto kërkesa. Në pozicionin D.1, specifikimet teknike kërkonin një rekuperator VENTAS ose ekvivalent me karakteristika të caktuara për dimensionet, kapacitetin e ngrohjes, dhe energjinë elektrike e cila nuk përputhet me katalogun e prezantuar nga Operatori Ekonomik "EJONA SH.P.K". Pasi që specifikimet teknike nuk përputhen me ato të prezantuara në katalogun e operatorit ekonomik, Autoriteti Kontraktues konfirmoi se specifikimet teknike të paraqitura nga Operatori Ekonomik "EJONA SH.P.K" nuk përputhen me kërkesat e specifikuar. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit ka vendosur që vendimi i marrë nga komisioni të qëndrojë, dhe është në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike (LPP) dhe rregullat relevante. Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 13.04.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0309, ndërsa me datë 24.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0309 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "EJONA Sh.P.K" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0309 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i ekspertit shqyrtues : Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin ankimor të OE ankuesit dhe ka gjetur se katalogu i tyre nuk përputhet me specifikimet teknike të dosjes së tenderit për pozicionin C1, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Në katalogun e ofruar, produkti i OE ankuesit ka specifika të ndryshme nga ato të kërkuara në dosjen e tenderit, duke përfshirë fuqinë e ndryshme të pompës termike. Në lidhje me pretendimin e OE ankuesit se Autoriteti Kontraktues ka bërë krahasime të paligjshme midis produkteve të tyre dhe atyre të një prodhuesi tjetër, eksperti shqyrtues sqaron se kjo çështje nuk është marrë parasysh si e mireqenë në vlerësimin e ofertës. Megjithatë, është kërkuar që kjo mosmarrëveshje të sqarohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimet Publike. Nga ana tjetër, OE ankuesi është kundërshtuar për mos pranimin e ofertës së tyre për pozicionin D1. Megjithëse ata argumentojnë se produkti i tyre ka specifika të ngjashme me ato të kërkuara në dosjen e tenderit, eksperti shqyrtues zbulon se ka dallime në disa elemente të specifikimeve teknike, siç janë peshat dhe dimensionet e pajisjes. Kjo bën që oferta e OE ankuesit të mos përputhet plotësisht me kriteret e specifikuar dhe të bëhet e pa pranueshme. Për të përfunduar, eksperti shqyrtues thekson se dosja e tenderit është dokumenti kryesor për vlerësimin e ofertave dhe ofertat duhet të përputhen plotësisht me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dokument. Me këtë rast, OE ankuesi mund të ketë kërkuar sqarime shtesë brenda afatit ligjor, por nuk e ka bërë këtë, duke e bërë pretendimin e tyre të pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se ankesa e OE ankues në këtë rast është e pabazuar. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues duke u bazuar në raportin e ekspertizës ka gjetur ankesa e OE duhet të refuzohet si e pabazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur tëmbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E PEJËS lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Insatlimi i ngrohjes dhe rregullimi i ndriqimit në Palestrën e sporteve Karagaq në Pejë LOT 1 Instalimi i ngrohjes qëndrore dhe ventilimit në Palestrën Karagaq" me nr. të prokurimit: "635-23-5904-5-1-1".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - " EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: